



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.18, datë 28.12.2022

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“RESORT DHE HOTEL 1, 2 DHE 5 KATE MBITOKË DHE 1, 2 KATE NËNTOKË”,
ME VENDNDODHJE NË MALIN SHËNGJIN, RANA E HEDHUN, BASHKIA LEZHË

Në mbështetje të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Gjergji” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Resort dhe Hotel, 1, 2 dhe 5 kate mbitokë dhe 1, 2 kate nëntokë”, me vendndodhje në Malin Shëngjin, Rana e Hedhun, Bashkia Lezhë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Gjergji” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Lezhë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi i KKT-së Nr.37, datë 27.07.2022, shfuqizohet.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MËDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOFA

